

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

Gjyqtar Besnik HOXHA

Me pjesmarjen e prokurorit Armand Gurakuqi, asistuar nga sekretare Florinda Nushi, sot me date 25-03-2021, mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore publike çeshtjen penale ne ngarkim:

TE PANDEHURIT: A. A , i biri i dhe, i dtl., lindur e banues në, i pa-dënuar, me masë sigurimi “*arrest në shtëpi*”, **në mungesë të vullnetshme**, përfaqësuar në gjykim nga Av. Alkënd Shpendi me Nr. 2859 Liçense, sipas prokurës së posacme Nr. 14399 Rep., Nr. 7132 Kol., dt. 05.12.2019. . 14399 Rep., Nr. 7132 Kol., dt. 05.12.2019.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “*Mashtrimi*” parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.

Viktima të veprës penale: Elalba shpk,, në mungesë;

H.... M...., i dtl., mbajtës i ID, NID G.....; **në mungesë;**

H.... I.... i biri i e, i dtl., lindur në R... e banues T..., Rruga e D..., banesë private Nr., në mungesë;

Sh.... D.... i biri i e, i dtl., lindur në e banues në, në mungesë;

A.... D.... i biri i e, i dtl., banues në; **në mungesë.**

F.... Sh... e bija e e, e dtl. ..., lindur në e banuese në, **në mungesë;**

“Deloitte Albania” sh.p.k., me seli në Rr. “Faik Konica”, Nd. 6, H 7, Tiranë, **(jo present);**

“Shërbimi ligjor falas”, Blv. “Bajram Curri”, Pallatet Agimi, Shk.18, Apt. 322, Tiranë, përfaqësuar nga Borana Resulaj, **(jo present)**

“Mali Lezhë” shpk, rruga kryesore Lezhë-Tiranë, Lagja “Zemra e Katundit”, **(jo present).**

Evita shpk, Rr. “Grigor Heba”, Pall. Nr.2, Apt. 2, Kati 2, Tiranë, **(jo present)**;

“Biba-X” sh.p.k., me administrator Barush Biba, me seli në Fshati Kryeluzaj, Kavajë, **(jo present)**;

ASIG (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor), me adresë: Rr. “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati 2, Tiranë, **(jo present)**;

Inspektorati Qendror pranë Kryeministrisë, Rr. “Frosina Plaku”, Br. 58, Godina e Observatorit, Tiranë, **(jo present)**;

NOA sh.a, Rr. “Tish Daia”, kompleksi Haxhiu (Kikia), Pall. 2, K.1., Tiranë, **jo present**;

Unioni Financiar Tiranë sha, me adresë: Rr. “Ismail Qemali, Nr. 32, Kati 3, Tiranë, përfaqësuar nga av. Genti Laci me Nr. 3603 Liçense, sipas autorizimit dt. 29.05.2020;

Interalba Logistic sh.p.k., Shëtitorja Taulantia, Durrës, **(jo present)**;

Zyra e Përfaqësimit Bayer d.o.o., Tiranë, Blv. “Gjergj Fishta”, Pallati pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, **(jo present)**;

Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, Rr. “Xhanfize Keko”, përballë Porcelanit, Tiranë, **(jo present)**;

Qendra “Hap”, Rr. “Themistokli Gërmenji”, pallati Helios, Nr. 10, Apt. 2/1, Tiranë, **(jo present)**;

UNI COM sh.a. Vorë, Gjokaj, Auto City, autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Tiranë, përfaqësuar nga av. Genti Laci me Nr. 3603 Liçense, sipas autorizimit dt. 29.05.2020;

TL-08 sh.p.k. Shkodër, **(jo present)**.

Arstl Group, Kombinat, ish-fabrika e tullave silikat, Rruga e Qelqit, Tiranë, **(jo present)**.

E. L. e dtl. ..., lindur e banuese në ..., Rr., banesë private Nr...., **(jo present)**;

Qendra e Realizimit të Veprave të Artit, Rruga “Qemal Stafa”, banesë private Nr.1/2, Tiranë, **(jo present)**.

Gjykata pasi administroi provat, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të Prokurorit, i cili kërkoi: Deklarimin fajtor të pandehurit **A. A.**, për veprën penale të “Mashtrimit”, të patashikuar nga neni 143/2 i K.Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim si dhe aplikimin e nenit 406 te K.Pr.Penale;

Av. A.Shpendi që kërkoi deklarin e pafajshëm të pandehurit Albano Aliko;

Av.G. Muca përfaqësuesi i shoqërisë “Uni Com” dhe “ Union Financiar Tirane” sh.a kërkoi deklarin fajtor të pandehurit A.Apër veprën penale të parashikuar nga neni 143/2 I K.Penal;

si deklaroi te mbyllyr shqyrtimin gjyqësor dhe bisedoi ceshtjen në tërësi .

VEREN :

Se, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është sjellë për gjykim procedimi penal Nr. 3250 /2018, me të pandehur **A. A-** akuzuar për veprën penale të “Mashttrimit”, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.

Nga aktet e seances paraprake rezulton se të pandehurit kanë kërkuar gjykim të shkurtuar, duke pranuar që gjykimi të zhvillohet në gjendjen që janë aktet në fashikullin e prokurorisë të sjellë për gjykim, ndaj dhe gjykata bazuar në nenet 405 të K.Pr.Penale, pasi u njoh me aktet hetimore, vendosi të procedojë me gjykim të shkurtuar, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjendjen që janë paraqitur aktet nga organi i prokurorisë, pasi nga palët nuk pati pretendime pavlefshmërie, papërdoshmërie, për aktet si dhe të tjera kërkesa paraprake të kësaj natyre.

Gjykata, në respektim të dispozitave ligjore (nenit 405 të K.Pr.Penale), duke vlerësuar se aktet janë të plota dhe se çështja mund të zgjidhet në gjendjen në të cilat ndodhen këto akte, vendosi zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, duke pranuar kërkesën e bërë nga i pandehuri. Në mbështetje të dispozitave të posaçme procedurale si dhe të Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Në këto kushte fashikulli (dosja) e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore duke marrë vlerën e provës pas pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Në këtë fashikull bazohen diskutimet përfundimtare të palëve si dhe gjykata në dhënien e vendimit.

Megjithate ka rezultuar plotesisht e provuar se :

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga ana e Seksionit për Krimin Ekonomik e Financiar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, ka regjistruar procedimin penal Nr. 3250 të vitit 2018. Nga aktet e administruara gjatë hetimeve paraprake rezulton se në shtetasi A... A..., i caktuar si përfaqësues me prokurat 4097/1028, dt. 20.12.2016, 4095/126, dt. 19.12.2016, 5037/1168, dt. 15.12.2017 dhe 5039/1169, dt. 15.12.2017, për shoqëritë “Sun Petroleum Albania” sh.a. dhe “Sun Petroleum Albania” sh.p.k, duke përdorur padijeninë e punonësive të këtyre shoqërive dhe të personave të tretë, ka realizuar shitje tek klientë të ndryshëm persona fizikë e juridikë (B. K., H. M., H. I., Sh. D., KLD, ASIG, Interalba Logistic sh.p.k., Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, UNI COM etj..), të tollonave për furnizim me karburant, në një kohë që shoqëria nuk dispononte sasi të përkatëse të produkteve të shitura. Sasia e tollonave është shitur në vlera shumë të ulët në raport me vlerën reale të tregut, për të bindur klientët që të realizonin blerjen e tyre, me qëllim për të përvetësuar sasi të ndryshme parash në mënyrë të paligjshme.

Se nga ana e Seksionit për Krimin Ekonomik e Financiar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, është referuar materiali i bazuar mbi kallëzimet e shtetasve Gj. M., B. K., H. M., H. I., Sh. D., A. D., F. Sh.. Kallëzimi është bërë pasi dyshohej se me anën e mashtrimit është përvetësuar një shumë të konsiderueshme lekësh, duke shitur tollona karburanti, në një kohë që shoqëria nuk ka pasur gjëndje sasi të këtij produkti. Në vijim të materialit të referuar janë dërguar pranë Prokurorisë edhe kallëzime të tjera të bëra nga

subjekte të ndryshme pranë organeve të policisë gjyqësore të Polcisë së Shtetit. Gjithashtu pranë Prokurorisë janë depozituar edhe kallëzime penale nga subjekte të tjera të cilat janë dëmtuar nga veprimet e kryera në emër të shoqërisë “Sun Petroleum Albania”.

Konkretisht, nga kallëzimet e bëra rezulton se shtetasi Gjerard Mema ka qenë menaxher shitjeje për shoqërinë “Sun Petroleum Albania” në qytetin e Durrësit. Kallëzuesi ka shpjeguar se detyra e tij ishte të shiste sa më shumë tollona nafte. Prej tre vjetësh ai ka krijuar klientelën e tij tek të cilët shiste në mënyrë të vazhdueshme tollona nafte. Tollonat që ka shitur në muajin prill 2018 kanë arritur në vlerën 40, 000 euro. Klientët janë paraqitur me tollona pranë shoqërisë po nuk kanë mundur të blejnë naftë dhe tollonat kanë dalë të pavlefshme.

Kallëzuesit e tjerë kanë pasur marrëveshje verbale me shoqërinë “Sun Petroleum Albania”, në bazë të së cilës të gjithë këta shtetas, merrnin tollona nafte me një vlerë 135 leke për litër. Tollonat në vijim do të mund të përdreshin pranë pikave të tregimit të karburantit të subjektit të mësipërm, duke u konvertuar në sasi të përkatëse të naftës.

Shoqëria drejtohej nga shtetasi I. S. (shtetas gjeorgjian) dhe **A. A.** Kallëzuesit kanë marre për një kohë të gjate naftë në shoqërinë e mësipërme. Ditët e fundit para bërjes së kallëzimeve penale, ato kanë shkuar pranë pikave të furnizimit të subjektit shitës dhe nuk kanë mundur të furnizohen me naftë, madje i kanë gjetur të mbyllura pikat e tregimit, ku nuk shërbehej as me tollona dhe as me leke ne dorë, për shkak të mungesës së karburantit.

Pasi viktimja H. M. nuk ka mundur të marrë sasinë e karburantit është paraqitur në zyrat e shoqërisë, ku ekonomistja i ka thënë se duhet të bisedonte me drejtorin e përgjithshëm **A. A.**

Shtetasi H. I. ka shpjeguar se blerja e tollonave i është orfuar nga shtetasi I. J.. Me këtë person ka shkuar në zyrat e shoqërisë ku shtetasja B. K. e ka futur në zyrën e drejtorin M. J., ku është paguar shuma 1,500,400 lekë për 22 pako tollona. Një pjesë të tollonave deklaruesi e ka shitur tek të afërmit e tij.

Shtetasja Sh. K., përfaqësuese e “Deloitte Albania” sh.p.k. ka deklaruar se nga maji 2017 ka blerë tollona në sasinë 15,000 litra, kanë konsumuar sasinë 2720 litra dhe kanë gjëndje tollona për sasinë 12,280 litra në vlerën 1,989,360 lekë. Nga kjo shtetase janë dorëzuar edhe tollonat përkatës.

Shtetasja B. R., financiere e organizatës jofitimprurëse “Shërbimi ligjor falas” Tiranë, ka deklaruar se nga viti 2015 kanë blerë karburant nëpërmjet tollonave nga shoqëria “Sun Petroleum Albania” sh.p.k. Personi me të cilin është komunikuar është shtetasja B. K., menaxhere shitjesh. PAGESA është bërë gjithmonë nëpërmjet bankës. Në datë 16.04.2018 është njoftuar nga shoferët e mjeteve të organizatës se nuk mund të furnizoheshin me karburant.

Ka takuar rastesisht në rrugë B.. e cila i ka thënë se nuk kishte dijeni mbi problemin dhe se i kanë nxjerrë me forcë nga shoqëria. Sasia totale e karburantit për të terhequr është 580 litra, me vlerë 100,000 lekë.

Shtetasi B.. B.. ka depozituar kallëzim në emër të shoqërisë “Biba-X”, në të cilën ka shpjeguar se ka blerë sasi naftë nga shoqëria e kallëzuar në shumat 5,000,000 lekë dhe 1,350,000 lekë.

Janë sekuestruar tollonat e naftës se lëshuara nga shoqëria “Sun Petroleum Albania”, të cilat disponoheshin nga kallëzuesit e veprës penale.

Është pyetur shtetasja A.. M., e cila për një periudhë 3 vjeçare, është shefe kontabiliteti e shoqëria “Sun Petroleum Albania”. Kjo shtetase ka deklaruar se furnizimi i fundit nga subjekti është bërë në datë 16.04.2018 pranë shoqërisë Glenklaudis. Ajo ka shtuar se **A.A** ka qenë Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, me prokurë të përgjithshme nga administratori, e cili vendoste për çdo gjë.

Shtetasja K.. M., asistente kontabiliteti pranë “Sun Petroleum Albania” shpk ka deklaruar se ka pasur për detyrë hedhjen e faturave të mbylljes ditore të shitjeve të karburantit nëpër stacione. Shitja e tollonave bëhet nga departamenti i shitjeve ku ishin shtetaset D.. D.. dhe B.. K... Lekët që mbledheshin nga tollonat zakonisht kalonin nga arka që menaxhohej prej saj por lekët derdheshin edhe në bankë.

Shtetasja A.. L., shefe e financës së shoqërisë “Sun Petroleum Albania” shpk ka deklaruar sa vijon: *Objekt i punës së saj është saktësia e raportimeve të aksionarët lidhur me shitjet e ditës në të gjithë vendin, depozitimim e xhiros, rakordimi i lekëve të arkëtuara nga tollonat e shitura, fitimi ditor i shitjes së karburantit, raportimi i të ardhurave dhe shpenzimeve.*

Cdo pikë kishte menaxherin e vet ose ka pasur një menaxher për dy ose tre stacione. Ato bënin derdhjen e xhiros ditorë në bankë, në llogaritë e shoqërisë. Të drejtën për të bërë lëvizje në llogarinë bankare e kanë pasur vetëm i.. S.. dhe A.. A...

Furnizimi i fundit është bërë në datë 16.04.2018 por deklaruesja nuk ka dijeni mbi sasinë e karburantit të blerë.

Nuk ka pasur dijeni mbi gjëndjen e depozitave nëpër stacione, pasi këtë e bënte departamenti i matjeve.

*Furnizimi bëhet nga furnitorët vendas Kast&Gas, Kastrati, Bolvoil, Gentklaudis etj... **A.A** ishte Drejtor i Përgjithshëm me prokurë nga administratori dhe bënte të gjithë organizimin e punës.*

Deklarim të ngjashëm ka dhënë edhe shtetasja B.. K., e cila ka qenë oficere shitjeje në shoqërinë “Sun Petroleum Albania” shpk. Ajo ka theksuar se me shitjen e tollonave është marrë shtetasi **A.A** ku konfirmimi për çdo gjë vinte nga ai.

Në deklaratimet e tijë shtetasi I.. S.. është shprehur se nuk është ne dijeni të situatës se shoqërisë pasi me një prokurë të posaçme ka autorizuar shtetasin **A. A.**, që ky i fundit të kryejë të gjitha veprimet ne emër të shoqërisë. Ka ardhur në Shqipëri në vitin 2013 dhe administrator në atë kohë ka qenë shtetasi G.. G., ndërsa shtetasi I.. S.. ka qenë zëvendësi i tij. Personi kontakti në atë periudhë në Shqipëri ka qenë shtetasi **A. A.**, i cili ka qenë administrator i Shoqërisë Alpet. A...u ka kërkuar që të blejnë shoqërinë Alpet, por nga verifikimet e bëra ka rezultuar se ajo shoqëri kishte probleme dhe nuk e kanë blerë. A. ka pasur disa pika karburanti Alpet, të cilat i tërhoqi dhe i kaloi në shoqërinë “Sun Petroleum Albania” sh.p.k, me qira. Pas G.. G., në fund të vitit 2015, administrator i shoqërisë është bërë shtetasi J.. M., i cili ka qëndruar deri në fund të vitit 2016. Nga fundi i vitit 2016 e deri tani administrator është shtetasi I.. S., i cili në datat 19.12.2016 dhe 20.12.2017, për të dyja shoqëritë “Sun Petroleum” sh.a dhe sh.p.k, i ka bërë një prokurë të posaçme shtetasit **A.A** për t’u përfaqësuar me tagër dhe pushtet të plotë për të vepruar dhe marrë të gjitha vendimet ne cilësinë e përfaqësuesit ligjor në llogari të shoqërisë, “Sun Petroleum” sha dhe sh.p.k. Këto shoqëri kanë një kontratë për 15 vjet me kompaninë mëmë që është “Gulf Oil Internacional”, me anën e se cilës mund të shesin karburant nën logon e tyre. Katër vitet e para karburantit e kanë importuar nga kompania mëmë, me pas një pjesë e kanë blerë nga kompania mëmë dhe një pjesë tjetër e kanë blerë nga distributorët në vend. Shpjegon se këto shoqëri kanë filluar të shpërndanin tollona nga fillimi i vitit 2016, por në një masë të vogël. Me ardhjen e A.. si drejtor i përgjithshëm i shitjeve, tollonat janë dhjetë fishuar.

Shtetasi I.. S... ka deklaruar se 2 pika të shoqërisë Sun Petroleum sh.p.k janë kthyer në Alpet dhe konkretisht pika që ndodhet në “M.. Sh..” dhe pika që ndodhet në K., për të cilat mendon se e gjitha kjo është “loja” e A...për t’u çuar në faliment të gjithë shoqërinë.

Shtetasi I.. S.. ka depozituar pranë policisë gjyqësore prokurat me të cilat shtetasi **A.A** është zgjedhur si përfaqësues me të drejta të plota i shoqërive “Sun Petroleum Albania” sh.p.k. dhe “Sun Petroleum Albania” sh.a. Prokurat janë të muajit dhjetor 2016 dhe dhjetor 2017.

Shtetasja A. L.. ka depozituar me procesverbalin e këqyrje-marrjes së datës 20.04.2018 pasqyrën financiare të shoqërisë “Sun Petroleum Albania” sh.p.k., e nënshkruar nga shtetasi **A. A.**

Shtetasi F.. K., përgjegjës i departamentit ligjor të shoqërisë “Sun Petroleum Albania” sh.p.k. ka deklaruar se nuk ka dijeni lidhur me problematikën e krijuar me shitjen e tollonave, për shkak se kjo pjesë e veprimtarisë mbulohet nga sektori i financave. Nuk ka dijeni se shoqëria të ketë pasur probleme financiare.

Nga komunikimet e shtetasit Gj.. M.. me **A. A.** ka rezultuar se A.. në datën 15.04.2018 i kërkon Gj.. që të shesë sa më shumë tollona dhe lekët e mbledhura t'i hedhë në llogari të Raiffeisen bank dhe BKT.

Në datën 13.04.2018 në llogarinë e A.B.I Exchange sh.p.k me administrator I.. D.., shtetasi Gj.. M.. ka derdhur një shume prej 995.200 ne Raiffeisen Bank.

Në datë 03.04.2018 shtetasi Gj.. M.. ka hedhur përsëri shumën prej 1.000.200 në llogarinë e A.B.I Exchange sh.p.k të Raiffeisen Bank.

Po në datën 03.04.2018 shtetasi Gj.. M.. ka derdhur shumën prej 1.000.000 në llogarinë e A.B.I Exchange sh.p.k të Raiffeisen Bank.

Në datën 29.03.2018 shtetasi Gj.. M.. ka hedhur serish shumën e 700.000 lekesh të rinj ne llogari të A.B.I Exchange sh.p.k të Raiffeisen Bank.

Në datën 28.03.2018 Gj.. M.. ka derdhur shumën 910.200 leke ne llogarinë e A.B.I Exchange sh.p.k të Raiffeisen Bank.

Në datën 21.03.2018 shtetasi **A.A** i kërkon shtetasit Gj.. M.. që të hedhë në llogarinë e Eurocosmetik sh.p.k në numrin e llogarisë 00030006395 të Raiffeisen bank shumën e 7200 euro.

Kallëzime shitesë të administruara në kuadër të procedimit penal. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka depozituar në datë 27.04.2018 kallëzim penal ndaj shoqërisë “Sun Petroleum Albania” shpk dhe administratorit të saj I... S... Nga ky kallëzim rezulton sa vijon: Bazuar në procedurën e prokurimit të vitit 2017, KLD ka lidhur kontratë blerje, (furnizimi) me shoqërinë “Sun Petroleum Albania” shpk për blerje gazoil 5.500 litra dhe 100 litra benzinë, në vlerën 840,901 lekë me TVSH. KLD është pajisur me 8 karta elektronike për t'i përdorur për furnizim. Në datë 19.04.2018 në media është përhapur lajmi i mbylljes së pikave të furnizimit me karburant të shoqërisë “Sun Petroleum Albania” shpk. Përfaqësuesi i KLD ka shkuar në pika të ndryshme të shitjes së këtij subjekti dhe ka konstatuar mbylljen e tyre. Bashkëlidhur kallëzimit është dërguar kontrata nr.1898/1, dt.05.06.2018 për blerje karburanti (e njehësuar me origjinalin). Në emër të shoqërisë “Sun Petroleum Albania” shpk. kjo kontratë është nënshkruar nga shtetasi **A.. A.**, i cili ka vepruar si përfaqësues me prokurë, mbi bazën e prokurës së datës 20.12.2016.

Kallëzim penal ka depozituar edhe subjekti NOA sh.a. Edhe ky subjekt ka lidhur kontratën e furnizimit dt.27.04.2017 me shoqërinë “Sun Petroleum Albania” shpk, përfaqësuar nga shtetasi **A.. A.**, i cili ka vepruar mbi bazën e prokurës së datës 20.12.2016. Cmimi i shitjblerjes është përcaktuar 19 lekë më i ulët se ai i publikuar në faqen eëë.gulf.al. Marrëdhënia ka funksionuar deri në fund të marsit 2018, ku kallëzuesi kryente porosi prej 6000-6500 litrash në muaj naftë dhe 300-400 litra në muaj benzinë. NOA sh.a. ka porositur për muajin prill 2018 sasinë 6000 litra naftë dhe 350 litra benzinë, duke parapaguar shumën 1,030,560 lekë. Nga kjo sasi është konsumuar 2,456 litra naftë dhe 0 litra benzinë. Vlera e pjesës së mbetur është 636,051 lekë. Në këto kushte kallëzuesi ka bërë kallëzim penal për kryerjen e veprës penale

“Mashtrimi” parashikuar nga neni 143 i K.P. Bashkëlidhur kallëzuesi ka depozituar edhe kontratën e furnizimit dt. 27.04.2017 me shoqërinë “Sun Petroleum Albania” shpk, përfaqësuar nga shtetasi **A.. A..**, i cili ka vepruar mbi bazën e prokurës së datës 20.12.2016. Gjithashtu është depozituar edhe vërtetimi bankar origjinal dt. 25.04.2018 i Raiffeisen Bank, nga i cili konfirmohet pagesa e shumës 1,030,560 lekë nga kallëzuesi.

Në datë 04.05.2018 subjekti Unioni Financiar Tiranë ka depozituar kallëzim penal ndaj shoqërisë “Sun Petroleum Albania” shpk. Subjekti kallëzues ka parapaguar totalisht ndaj “Sun Petroleum Albania” shpk sa vijon: 2000 litra Diesel, vlera 316,000 lek me TVSH; 1000 litra Diesel, vlera 158,000 lek me TVSH, 1000 litra Diesel, vlera 158,000 lek me TVSH. Prej datës 19 prill 2018 subjekti kallëzues nuk mund të furnizohet në pikat e shitjes së karburantit Gulf. Bashkëlidhur kallëzimit janë depozituar edhe komunikimet e zhvilluara mes punonjës së Unioni Financiar Tiranë M..P.. me punonjësën e “Sun Petroleum Albania” shpk. B.. K.. Nga këto komunikime rezulton se shtetasja B..., në përgjigje të kërkesës së shtetases M... për furnizimin me karburantin e mbetur, shprehet: *“Besoj se do reagojnë, të paktën ne kështu na kanë thënë. As ne nuk dinim asgjë se çfare po ndodhte vetëm kur na thanë dilni nga zyrat se ka ardhur policia”*.

Bazuar në aktet e administruara rezulton se vlera e parave të paguara nga subjektet e dëmtuar është si më poshtë:

Elalba shpk, rruga e D.., Pallati F.. nr.., kulla nr..., kati i parë, aksionar deklaruesi B. K., cmimi 135 lekë/litër, sasia 17,500 litra, muaji tetor 2017, shitësi i tollonave Gj... M...- shuma 607,500 lekë;

Shtetasi H... M.. (kallëzues/deklarues), , përdor mjetin autobus me targë, cmimi 135 lekë/litër, sasia 5000 litra, muaji prill 2018, shitësi i tollonave Gj.. M., konsumuar 180 litra, mbetur tollona për 4820 litra- shuma 675,000 lekë;

Shtetasi H.. I.. (kallëzues/deklarues), pallati, cmimi i papërcaktuar, sasia 11000 litra, muaji prill 2018, ofruesi i tollonave I. J., punonjësja B. K. dhe drejtori M. J. në zyrën e të cilit është bërë pagesa, tollona 22 pako - shuma 1,500,400 lekë;

Shtetasi Sh.. D.. (kallëzues/deklarues), shofer autobusi linja Tiranë-Durrës, cmimi i papërcaktuar, sasia 30000 litra, muaji prill 2018, shitësi i tollonave Gj.. M., një sasi tollonash është shpërndarë tek persona të tretë, sasia e pakonsumuar e papërcaktuar;

Shtetasi A.. D.. (kallëzues/deklarues), cmimi 154 lekë/litër, sasia e blerë 6000 litra, vlera e pagesës 924,000 lekë me bankë (Alpha Bank) sasia e marrë e papërcaktuar, dhjetor-prill kryer tërheqje, shitësi i tollonave A.. S., një sasi tollonash është shpërndarë tek persona të tretë, sasia e pakonsumuar e papërcaktuar;

Shtetasja F.. Sh.., ekonomiste pranë “Ri-Grent” sh.p.k., Shkodër. Dt.16.04.2018 blerë 300 litra, cmimi 162 lekë, vendi zyrat e shoqërisë në Laprakë, Tiranë, shitësja B.. K...

“Deloitte Albania” sh.p.k. rruga e Elbasanit, pallati poshte Gjeologji Miniera, Tiranë.

“Shërbimi ligjor falas”, bulevardi Bajram Curri, pallatet Agimi, shk. 18, apt. 322, Tiranë, sasia totale e karburantit të pëtërhequr është 580 litra, me vlerë 100,000 lekë.

“Mali Lezhë” shpk, rruga kryesore Lezhë-Tiranë, lagja “Zemra e Katundit”, sasi e pafurnizuar naftë 1000 litra karburant.

Subjekti Evita shpk, deklaruese N.. K., rruga G.. H., pallati Nr. ., apt. ., kati 2, Tiranë, sasi e pafurnizuar naftë 2000 litra, blerë me 150 lekë/litri.

“Biba-X” sh.p.k., administrator B.. B., Lekaj Karizaj, fshati Kryeluzaj, pika interte 50 m pranë karburant Eurodrin, sasi naftë në shumat 5,000,000 lekë dhe 1,350,000 lekë, koha shkurt 2018 e në vijim.

ASIG (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor), rruga papa Gj.. P.. II, nr., kati ., 615 litra pa tërhequr, vlera 94095 lekë.

Inspektorati Qendror pranë Kryeministrisë, rruga F... P., Nr. 58, Godina e Observatorit, sasia prej 930 litra karburant e pafurnizuar.

NOA sh.a, rruga T.... D..., kompleksi H... (K..), pall. 2, k. 1. Edhe ky subjekt ka lidhur kontratën e furnizimit dt.27.04.2017 me shoqërinë “Sun Petroleum Albania” shpk. NOA sh.a. ka porositur për muajin prill 2018 sasinë 6000 litra naftë dhe 350 litra benzinë, duke parapaguar shumën 1,030,560 lekë. Nga kjo sasi është konsumuar 2,456 litra naftë dhe 0 litra benzinë. Vlera e pjesës së mbetur është 636,051 lekë.

Unioni Financiar, Tiranë, rruga Ismail Qemali, nr. 32, kati 3: 2000 litra Diesel, vlera 316,000 lek me TVSH; 1000 litra Diesel, vlera 158,000 lek me TVSH; 1000 litra Diesel, vlera 158,000 lek me TVSH.

Interalba Logistic sh.p.k., shëtitörja Taulantia, Durrës, vlera 161.000 ALL.

Zyra e Përfaqësimit Bayer d.o.o., Tiranë, blv Gj.. F., pallati pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, - sasia 815,25 litra Diezel Xtream, 115,62 litra Unleaded 950 OKT.

Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, rruga Xh... K., përballë Porcelanit, - 300,000 lekë.

Qendra Hap, rruga Th.... G., pallati H., nr..., ..- sasia 4640 litra naftë.

UNI COM sh.a. Vorë, Gj., Auto City, autostrada Tiranë-Durrës, km 8, në vlerën korresponduese të sasisë 177 litra naftë dhe 87.04 litra benzinë.

Arstl Group, Kombinat, ish fabrika e tullave silikat, rruga e Q..., Tiranë, sasia karburant e pafurnizuar ne vlerën 457, 549 lekë.

Entela Liço, rruga Q... S., banesë private nr.1/2, Tiranë, sasi e pafurnizuar naftë 400 litra naftë.

Qendra e Realizimit të Veprave të Artit, rruga Q S., banesë private nr. 1/2, sasi e pafurnizuar naftë 50 litra naftë (kallëzim nga E.. L.).

Nga të gjitha këto prova krijohet tërësisht bindja se i pandehuri i ka mashtruar të dëmtuarit dhe se qëllimi tij ka qenë përvetësimi i shumave të parave për përfitime materiale dhe moskthimi më i tyre.

Ndërsa neni 143/2 i Kodit Penal parashikon se:

“Vjedhja e pasurisë me anën e gënjeshtërs ose shpërdorimit të besimit dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet”.

“Po kjo veprë e kryer më shumë së njëherë dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet burgim”.

Sa më sipër rezulton e provuar se i pandehuri **A.Ak** a konsumuar elementët e vepres penale të **“Mashtrimit”** të parashikuar nga neni **143/2** i Kodit Penal.

Akuza ne ngarkim të pandehurit A.A është provuar si gjatë hetimeve paraprake, ashtu edhe në séancë gjyqësore me kallzimet penale të subjekteve Evita, Biba-X, Noa, Unioni Financiar, Interalba Logistic, Deloitte Albania etj., process verbal I personave që kanë dijeni, process-verbale të ardhura nga QKR, Drejtoria Rajonale Tatimeve, pasqyrat Financiare, process verbal kontrolli dhe sekuestrimi të sendeve e në tërësi aktet e ndodhura në fashikullin e procedimit penal Nr.3250 të vitit 2018, të cilat si u moren për shqyrtim u administruan në dosje dhe që në referim të **vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 2, date 29.01.2003, duke zbatuar gjykimin e shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore.**

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar paprekshmërinë e pasurisë të personave fizikë, juridike ose të shtetit.

Nga ana objektive, kjo veprë penale kryhet në forma e mënyra të ndryshme që konsistojnë në veprime aktive kriminale që kanë si pikësynim që nëpërmjet përdorimit të gënjeshtërs ose shpërdorimit të besimit, kalimin e pronësisë nga pronari tek subjekti kriminal, me qëllim përfitimin material dhe moskthimin më të saj. Gënjeshtër është paraqitja e rreme e gjendjes nga subjekti në mënyra të ndryshme dhe për pasojë shtyrjen e të dëmtuarit në gabim për shkak të së cilës ai dorëzon pasurinë ose bën ndonjë veprim me karakter pasuror. Kjo konsiston në veshjen e subjektit me cilësi, të cilat ai nuk i gëzon, por këto i nevojiten për të kryer mashtrimin.

Nga ana subjektive kjo veprë penale kryhet me dashje. Një element i domosdoshëm i anës subjektive është qëllimi i nxjerrjes së përfitimeve materiale për vetë ose për të tjerët dhe moskthimi më i pasurisë.

Në rastin konkret rezulton e provuar se i pandehuri A.A ka paraqitur fakte të rreme, konkretisht duke shitur tollona naftë duke krujuar tek blerësit bindjen si mbi bazën e tyre ato do të mundeshin të blinin sasi të përkatëse të naftës, është konsumuar ana objektive duke fshehur nga blerësit e tollonave faktin se shoqëria nuk kishte sasi naftë gjëndje, pasi furnizimi i fundit është kryer më dt.16.04.2018. Duke fshehur faktet e vërteta është ulur çmimi I naftës prej 135 lekë për litër në raport me çmimin e treguat të naftës, rrethanë e cila mbështet dyshimin se shitja e tollonave ka pasu si qëllim të vetëm përfitimin e parave nëpërmjet mashtrimit dhe jo shitjen reale të karburantit. Veprime këto të kryera me dashje dhe pse dihej fakti se shoqëria “Sun Petroleum Albania” nuk kishte sasi naftë në dispozicion, ka vijuar shitjen e tollonave.

Nisur nga sa më sipër gjykata cmon se lloji dhe masa e dënimit kërkuar nga prokurori është i përshtatshëm për këte të pandehur.

PER KETO ARSYE:

Mbeshtetur ne nenet 384 e 390 te Kodit Pr. Penale Gjykata

V E N D O S I:

-Deklarimin fajtor të pandehurit **A.. A..**, për kryerjen e veprës penale të “
Mashttrimit “ parashikuar nga neni 143/2 të Kodit Penal në me shumë se një
herë dhe në baze të kësaj dispozite e dënon ate me **4 (kater) vjet burgim.**

- Në aplikim te nenit 406/1 te K.Pr.Penale mases së mësipërme i zbritet 1/3 e
saj dhe përfundimisht i pandehuri **A.A** dënohet me **2 (dy) vjet e 8 (tete) muaj
burgim.**

-Vuajtja e denimit për të pandehuren fillon nga dt.10-09-2018 dita
ekzekutimit të masës sigurimit “ arrest në burg” dhënë me vendimin Nr.830
dt.10.05.2018 të Gjykates Rrethit Gjyqësor Tirane, duke urdhëruar që kjo
vuajtje të kryhet në një nga Burgjet e Sigurise Zakonshme.

-Në baze të nenit 190 të K. Penal provat materiale të sekuestruara të
dt.19.04.2018 ti kthehen shtetasit H.M...

-Provat e sekuestruara të dt.19.04.2018 ti kthehen shtetasit B.. K..

-Provat e sekuestruara te dt.19.04.2018 ti kthehen shtetasit A.. D...

-Provat e sekuestruara të dt.19.04.2018 ti kthehen shtetasit Sh.. D...

-Provat e sekuestruara të dt.25.04.2018 ti kthehen shtetases Sh.. K..

-Provat e sekuestruara të dt.20.04.2018 ti kthehen shtetasit E.. L...

-Provat e sekuestruara të dt.20.04.2018 ti kthehen shtetasit A.. T...

-Provat e sekuestruara të dt.20.04.2018 ti kthehen shtetasit U.. N...

-Provat e sekuestruara të dt.24.05.2018 ti kthehen shtetasit P.. G...

-Provat e sekuestruara të dt.22.08.2018 ti kthehen shtetasit A.. M...

-Shpenzimet proceduriale dhe ato gjyqesore i ngarkohen të pandehurit.

-Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brënda 15
ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall ne Tirane, sot me date 25-03-2021

S E K R E T A R E

GJYQTARI

Florinda NUSHI

Besnik HOXHA

SHPENZIMET GJYQESORE

Taksa njoftimit 22 x150 leke

Shpenzimet ne veprimet paraprake 4200 leke